



XXe Congrès de la Conférence des Cours constitutionnelles européennes
XXth Congress of the Conference of European Constitutional Courts
XX. Kongress der Konferenz der Europäischen Verfassungsgerichte

CE
CC

2024/27

**STATUTI I KONFERENCËS SË GJYKATAVE
KUSHTETUESE EVROPIANE**

Statuti i Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane

A. Preambula

Kryetarët e Gjykatave Kushtetuese Evropiane dhe institucioneve të tjera të ngjashme evropiane që ushtrojnë juridiksion kushtetues deklarojnë synimin e tyre për të organizuar, në përputhje me praktikën e krijuar deri më tani, konferenca të rregullta me qëllim shkëmbimin e përvojave që lidhen me praktikën dhe juridiksionin kushtetues në një kontekst të përgjithshëm evropian dhe mbajtjen e kontakteve të rregullta mes këtyre gjykatave dhe institucioneve, duke u bazuar në respektin e ndërsjellë dhe në parimin e pavarësisë gjyqësore.

B. Dispozitat e Statutit

Seksioni I. Dispozita të përgjithshme

Neni. 1

Emërtimi

Emri i konferencës do të jetë "Konferenca e Gjykatave Kushtetuese Evropiane".

Neni. 2

Statusi juridik

Ekzistenca e Konferencës rrjedh nga deklarata e përbashkët e Kryetarëve të Gjykatave Kushtetuese Evropiane dhe institucioneve ekuivalente. Ajo nuk ka efekt juridik detyrues jashtë Konferencës.

Neni 3

Qëllimi

Konferenca do të mbajë një Kongres në interval të rregullt. Ajo do të promovojë shkëmbimin e informacionit për metodat e punës dhe praktikën gjyqësore të gjykatave anëtare, së bashku me shkëmbimin e mendimeve për çështje institucionale, strukturore dhe operacionale në lidhje me të drejtën publike dhe juridiksionin kushtetues. Gjithashtu, ajo do të ndërmarrë hapa për të rritur pavarësinë e gjykatave kushtetuese si një faktor thelbësor në garantimin dhe zbatimin e demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, duke pasur si qëllim veçanërisht, sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Ajo do të mbështesë përpjekjet për të mbajtur kontakte të rregullta midis Gjykatave Kushtetuese Evropiane dhe institucioneve të ngjashme.

Neni 4

Anëtarësia

Anëtarët e Konferencës do të jenë sipas kategorive të mëposhtme:

1. Anëtarët me të drejta të plota.

Anëtarët me të drejta të plota do të kenë të drejta të plota të marrin pjesë në të gjitha çështjet që lidhen me Konferencën. Në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Rregullores së Konferencës, ata do të përballojnë në mënyrë të barabartë shpenzimet për organizimin e takimeve të Kongresit.

2. Anëtarët e asociuar.

Anëtarët e asociuar përgjithësisht do të kenë të drejtë të paraqesin propozime, të marrin pjesë në Kongres dhe të hartojnë e paraqesin një raport kombëtar mbi tema specifike për programin e Kongresit.

Anëtarët e asociuar nuk i nënshtrohen detyrimeve të përgjithshme për të marrë pjesë në ndarjen e shpenzimeve.

Rregullorja e Konferencës parashikon dispozita më të detajuara lidhur me këtë gjë

Neni 5

Vëzhguesit dhe të ftuarit

Konferenca mund të pranojë vëzhgues dhe të ftuar në veprimtaritë e saj. Rregullorja e Konferencës parashikon dispozita më të detajuara lidhur me këtë gjë.

Seksioni II. Marrja dhe Humbja e Anëtarësisë

Neni 6

Marrja e statusit të anëtarit

1. (a) Statusi i anëtarit me të drejta të plota mund t'i jepet vetëm Gjykatave Kushtetuese Evropiane dhe institucioneve të ngjashme Evropiane, të cilat ushtrojnë juridiksion kushtetues e veçanërisht kontrollin e pajtueshmërisë së legjislacionit dhe që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjyqësore në përputhje me parimin e pavarësisë gjyqësore, duke iu nënshtuar parimeve themelore të demokracisë dhe shtetit të së drejtës dhe detyrimit për të respektuar të drejtat e njeriut. Në këtë aspekt, Konferenca do të ndjekë praktikën e krijuar nga konferencat e mëparshme dhe Këshilli i Evropës.

(b) Statusi i anëtarit të asociuar mund t'i jepet Gjykatave Kushtetuese Evropiane dhe institucioneve të ngjashme që nuk kërkojnë anëtarësi me të drejta të plota, ose që nuk përmbushin (ende) kriteret për anëtarësi me të drejta të plota.

2. Vetëm një institucioni nga çdo shtet mund t'i jepet statusi i anëtarit me të drejta të plota.

3. Pranimi në Konferencë nuk është një e drejtë.

4. Kërkesa me shkrim për pranimin në Konferencë duhet t'i drejtohet "Rrethit të Kryetarëve" dhe t'i paraqitet Kryetarit të "Rrethit të Kryetarëve".

5. Për aq sa është e mundur, kërkesa duhet të shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

(a) instrumentet ligjore që rregullojnë krijimin dhe përbërjen e institucionit kandidat, emërimin dhe statusin e gjyqtarëve;

(b) tekstet që përcaktojnë natyrën dhe fushën e veprimit të juridiksionit të tij;

(c) dokumente që tregojnë juridiksionin e ushtruar në të vërtetë.

Neni 7

Humbja e anëtarësisë

1. Çdo anëtar mund të deklarojë në çdo kohë qëllimin e tij për t'u tërhequr nga Konferenca. Kjo deklaratë duhet të jetë me shkrim.

2. Kur një anëtar nuk arrin të përmbushë pa arsye të mjaftueshme detyrimin e tij për të kontribuar në financimin e përbashkët të Konferencës, ose kur ka një arsye tjetër të rëndësishme për të arritur në përfundimin se bashkëpunimi efektiv në mirëbesim ndërmjet Konferencës dhe një anëtari nuk është më i mundur, anëtarit mund t'i deklarohet se i ka humbur anëtarësia.

Në rastin e pezullimit për mos-përmbushjen e detyrimeve financiare, në parim ky pezullim do të pushohet me bërjen e pagesave të shumave përkatëse.

Seksioni III. Organet e Konferencës

Neni 8

Organet

Organet e Konferencës do të jenë:

1. Rrethi i Kryetarëve;

2. Kongresi.

Neni 9

Rrethi i Kryetarëve

1. Përbërja:

"Rrethi i Kryetarëve" përbëhet nga Kryetarët e Gjykatave dhe institucioneve ekuivalente me statusin e anëtarit me të drejta të plota. Kryetarët shoqërohen nga Sekretari i Përgjithshëm, ose, kur është e përshtatshme, nga një anëtar i gjykatës ose nga një përfaqësues i sekretariatit.

2. Kompetenca:

"Rrethi i Kryetarëve" është organi qendror vendimmarrës dhe ka kompetencë në çështjet e mëposhtme:

- (a) pranimin, pezullimin dhe përjashtimin e anëtarëve;
- (b) pranimin dhe përjashtimin e vëzhguesve dhe të ftuarve;
- (c) përcaktimin e datës dhe vendit të mbledhjeve të Kongresit që do të mbahen në intervale të rregullta; zgjedhjen e temave dhe përcaktimin e gjuhëve të punës të Konferencës;
- (d) miratimin e buxhetit të Konferencës;
- (e) përcaktimin e kontributeve financiare për Kongresin;
- (f) miratimin e dhurimeve financiare nga një palë e tretë;
- (g) miratimin e deklaratës përfundimtare të Kongresit;
- (h) hartimin e rregulloreve të Konferencës;
- (i) ndryshimin e Statutit;
- (j) shpërndarjen e Konferencës.

3. Kryesia

Kryetari i Gjykatës i cili do të presë Kongresin tjetër do të kryesojë "Rrethin e Kryetarëve". Kur ai është duke u marrë me çështje që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me përgatitjet për Kongresin tjetër, Rrethi i Kryetarëve mund të caktojë një nga anëtarët e tjerë të tij për të kryesuar atë.

4. Takimet:

Rrethi i Kryetarëve zhvillon, mundësisht, të paktën një takim midis datave të Kongresit dhe, në parim, në ditën që paraprin hapjen e Kongresit.

Ftesa me shkrim shoqërohet me agjendën e mbledhjes.

5. Vendi i zhvillimit të takimeve:

Rrethi i Kryetarëve, si rregull, mbledhet në selinë e Gjykatës përgjegjëse për organizimin e Kongresit të ardhshëm. Në ndonjë rast të veçantë, Rrethi i Kryetarëve mund të caktojë zhvillimin e takimit në një vend tjetër.

6. Kuorumi:

(a) Rrethi i Kryetarëve ka të drejtë të marrë vendime nëse janë të pranishëm ose përfaqësuar në mbledhje të paktën gjysma e anëtarëve të Rrethit të Kryetarëve.

(b) Një gjyqtar, Sekretari i Përgjithshëm ose një anëtar i caktuar nga stafi i gjykatës mund të përfaqësojë Kryetarin në mbledhje dhe të votojë në emër të tij.

7. Rregullat e votimit:

(a) Rrethi i Kryetarëve merr vendime me një shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të pranishëm në një mbledhje.

(b) Abstenimet llogariten si vota negative.

(c) Secili anëtar ka vetëm një votë.

Neni 10

Kongresi

Përbërja:

Në Kongres kanë të drejtë të marrin pjesë si vijon: anëtarë me të drejta të plota, anëtarë të asociuar, vëzhgues dhe të ftuar.

Dispozitat e detajuara në lidhje me këtë pikë përcaktohen në Rregulloret e Konferencës.

Seksioni IV. Financimi

Neni 11

Parimet e financimit

1. Rregulla të përgjithshme për ndarjen e shpenzimeve:

Konferenca financohet kryesisht nga kontributet e barabarta të anëtarëve me të drejta të plota. Në këtë rast, zbatohen rregulloret kombëtare financiare dhe buxhetore.

2. Kostot e tjera dhe financimi i tyre:

(a) Kontributet e barabarta të anëtarëve me të drejta të plota mbulojnë kostot e organizimit të Kongresit (veçanërisht marrjen me qira të ambienteve, kostot e printimit, përkthimit dhe interpretimit, shpenzimet e përgjithshme administrative dhe koston e transportit për në vendet e ku do të zhvillohen veprimtaritë kryesore dhe takimet përgatitore).

(b) Rrethi i Kryetarëve mund t'u kërkojë anëtarëve të asociuar dhe vëzhguesve të paguajnë një tarifë për të kontribuar në shpenzimet e organizimit të Kongresit. Kjo tarifë do të përcaktohet në përputhje me shpenzimet e bëra për shërbimet e ofruara nga Konferenca kundrejt anëtarëve të asociuar dhe vëzhguesve, duke marrë parasysh kontributin e paguar nga anëtarët me të drejta të plota.

Dispozitat e detajuara në lidhje me këtë pikë përcaktohen në Rregulloret e Konferencës.

(c) Pranimi i të gjitha llojeve të dhurimeve financiare nga palët e treta do t'i nënshtrohet miratimit paraprak të Rrethit të Kryetarëve.

3. Buxheti i Konferencës:

Gjykata që organizon Kongresin harton, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe jo më vonë se një vit para hapjes së Kongresit, një buxhet për Kongresin i cili paraqitet për miratim në Rrethin e Kryetarëve.

4. Shlyerja përfundimtare e llogarive:

Shlyerja përfundimtare bëhet në bazë të një deklarate përfundimtare të llogarive të hartuar nga Gjykata organizative pas përfundimit të Kongresit.

Neni 12

Deklarata përfundimtare dhe aksesit i publikut.

1. Në fund të Kongresit, Rrethi i Kryetarëve mund të miratojë një deklaratë përfundimtare që tregon gjykatat kushtetuese dhe institucionet e përfaqësuar në Kongres, përshkruan zhvillimin e konferencës dhe përcakton përfundimet kryesore të arritura pas diskutimeve të asamblesë plenare.

2. Punimet e Kongresit nuk janë të hapura për publikun.

3. Kryetari i Konferencës - i shoqëruar, nëse është e nevojshme, nga anëtarët e tjerë të Rrethit të Kryetarëve - bën publike deklaratën përfundimtare në një konferencë për shtyp dhe jep informacion shtesë për përfaqësuesit e mediave (shtypi, radio, televizion).

Neni 13

Sekretariati

Sekretariati i Konferencës do të sigurohet nga Gjykata që organizon Kongresin tjetër të radhës.

Seksioni V. Dispozita përfundimtare

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Asambleja e Kryetarëve. Ai hartohet në frëngjisht, anglisht, gjermanisht dhe rusisht.

Versioni frëngjisht do të jetë autentik.

Miraturar unanimisht në votimin përfundimtar të "Rrethit të Kryetarëve" më 17 maj 1999 në Varshavë.

Në vitin 2012, teksti u redaktua për të korrigjuar gabimet ortografike dhe gjuhësore.